

**VENDIM**  
**Nr. 456, datë 10.6.2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 910, DATË  
21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ÇËSHTJET, OBJEKT  
KONSULTIMI, DHE STRUKTURËN, PROCEDURËN, FORMËN, MËNYRËN E  
ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KONSULTATIV TË  
QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën “c”, të pikës 4, pas nënndarjes “viii”, “mbrojtjen e konsumatorëve” shtohet nënndarja “ix”, me këtë përmbajtje:

“ix) diaspora dhe migracioni;”.

2. Në pikën 7, të kreut III, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në fjalinë e parë, numri “9 (nëntë)” zëvendësohet me numrin “11 (njëmbëdhjetë)”;

b) Pas nënndarjes “zëvendësministri përgjegjës për arsimin” shtohen nënndarjet, me këtë përmbajtje:

“- Përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën;

- Përfaqësuesi i ministrit përgjegjës për mbrojtjen e sipërmarrjes.”.

c) Fjalët “... 2 kryetarë bashkie ...” zëvendësohen me “... 3 (tre) kryetarë bashkie ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe ministri i Shtetit për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**